



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**

SHTOJCA 1.17

Rregullorja e këshillit studentor

1.17



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË



**RREGULLORJA PËR ORGANIZIMIN DHE ZGJEDHJEN E
KËSHILLIT STUDENTOR TË UNIVERSITETIT "FAN S.
NOLI"**



Përmbajtja

KREU I	6
DISPOZITA DHE PËRCAKTIME TË PËRGJITHSHME	6
NENI 1	6
BAZA LIGJORE	6
NENI 2	6
EMËRTIMI I ORGANIZMIT	6
NENI 3	6
PËRKUFIZIME	6
NENI 4	6
OBJEKTI I RREGULLORES	6
NENI 5	6
SUBJEKTI I RREGULLORES	6
KREU II	6
ORGANIZIMI DHE VEPRIMTARIA E KSUFSN	7
NENI 6	7
QËLLIMET E KSUFSN	7
NENI 7	7
PARIME TË PËRGJITHSHME	7
NENI 8	7
VEPRIMTARIA E KSUFSN	7
NENI 9	8
ORGANIZIMI I KSUFSN	8
NENI 10	8
KOMPETENCAT E KSUFSN DHE KSUFSN TË FAKULTETIT	8
NENI 11	8
PËRBËRJAE KSUFSN	8
NENI 12	8
PËRBËRJA E KSUFSN	9
NENI 13	9
KRYETARI I KSUFSN DHE I FAKULTETIT	9
NENI 14	9
KOMPETENCAT E KRYETARIT TË KSUFSN	9
NENI 15	10




NËNKRYETARI I KSUFSN DHE I FAKULTETIT	10
NENI 16	10
SEKRETARI I KËSHILLIT TË STUDENTËVE	10
NENI 17	10
SENATORI I KSUFSN	10
NENI 18	10
DETYRIMET E ANËTARIT TË KSUFSN	10
NENI 19	11
KSUFSN DHE UNIKO	11
NENI 20	11
SHKARKIMI I KRYETARIT	11
NENI 21	11
SHKARKIMI I NËNKRYETARIT, SEKRETARIT DHE SENATORIT TË KSUFSN	11
KREU III	12
MËNYRA E ZGJEDHJES	12
NENI 22	12
TË PËRGJITHSHME	12
NENI 23	12
PERIUDHA ZGJEDHORE DHE THIRRJA E ZGJEDHJEVE	12
NENI 24	12
KOMISIONET ZGJEDHORE	12
NENI 25	12
ORGANIZIMI DHE MËNYRA E FUNKSIONIMIT TË ZGJEDHJEVE	12
NENI 26	13
KOMISIONET E ZGJEDHJEVE	13
NENI 27	13
KOMPETENCAT E KIZS	13
NENI 28	13
KOMPETENCAT E KZFS	13
NENI 29	14
ZGJEDHËSIT DHE PËRGATITJA E LISTËS SË ZGJEDHËSVE	14
NENI 30	14
DOKUMENTACIONI PËR KANDIDIM	14
NENI 31	15



KANDIDIMI PËR KRYETAR TË KSUFSN	15
NENI 32	15
KANDIDIMI PËR NËNKRYETAR	Error! Bookmark not defined.
NENI 33	15
KANDIDIMI PËR SEKRETAR I KËSHILLIT TË STUDENTËVE	15
NENI 34	15
KANDIDIMI PËR SENATOR DHE MËNYRA E ZGJEDHJES	15
NENI 35	15
FUSHATA ZGJEDHORE	15
KREU V	16
PËRGATITJA E INFRASTRUKTURËS DHE DOKUMENTACIONIT	16
NENI 36	16
VENDNDODHJA E KOMISIONEVE ZGJEDHORE DHE VENDEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE	16
NENI 37	16
KOMISIONET PËR VLERËSIMIN DHE NUMËRIMIN E VOTAVE	16
NENI 38	16
PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT ZGJEDHOR	16
NENI 39	16
DËRGIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE NGA KIZS-JA NË KZSF	16
KREU VI	17
VOTIMI	17
NENI 40	17
VEPRIMET PARAPRAKE PËR HAPJEN E QENDRËS SË VOTIMIT	17
NENI 41	17
PROCEDURA E VOTIMIT	17
NENI 42	18
MBYLLJA E VOTIMIT	18
NENI 43	18
VEPRIMET PAS MBYLLJES SË QENDRËS SË VOTIMIT	18
NENI 44	18
VLERËSIMI, NUMËRIMI I VOTAVE DHE NXJERRJA E REZULTATIT PËR ZGJEDHJET E KSUFSN	18
NENI 45	20
SHPLLJA E REZULTATIT PARAPRAK TË ZGJEDHJEVE PËR KSUFSN	20



NENI 46	20
ANKIMIMET	20
NENI 47	20
KOMISIONI I APELIT STUDENTOR	20
NENI 48	20
KONSTITUIMIT I KSUFNS DHE KSF-VE	20
NENI 49	21
PAVLERFSHMËRIA E ZGJEDHJEVE	21
NENI 50	21
DETYRIMET TË UNIVERSITETIT PËR KSUFNS	21
NENI 51	21
FINANCIMI I VEPRIMTARISË SË KSUFNS	21
NENI 52	21
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT	21



KREU I DISPOZITA DHE PËRCAKTIME TË PËRGJITHSHME

NENI 1 BAZA LIGJORE

Kreu IX "Studentët dhe të dhënat mbi studentët", Neni 97, 98, 99 i Ligjit Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe Statutit të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, Kreu VII, Neni 56, 57, 58, 59; hartohet kjo Rregullore "*Për organizimin dhe zgjedhjen e këshillit studentor të Universitetit "Fan S. Noli"*".

NENI 2 EMËRTIMI I ORGANIZMIT

Emërtimi i organizmit do të jetë "Këshilli Studentor i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë (KSUFSN).

NENI 3 PËRKUFIZIME

Për qëllime të kësaj rregullore:

UNIKO – Universiteti "Fan S. Noli" Korçë

KSUFSN është Këshilli Studentor i Universitetit "Fan S. Noli",

SKS është Sekretar i i Këshillit Studentor

KSF është Këshilli i Studentëve në Fakultete

KIZS është Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor;

SENATOR quhet studenti i zgjedhur nga trupa zgjedhore e studentëve për të përfaqësuar programin studimor të një viti.

NENI 4 OBJEKTI I RREGULLORES

Kjo rregullore përcakton rregullat për organizimin e këshillit studentor si dhe, përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Studentor të Universitetit të Korçës "Fan S. Noli" në nivel njësie kryesore dhe institucioni. Gjithashtu përcakton kushtet e afatet për regjistrimin e kandidatëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre, dokumentacionin zgjedhor, listat e zgjedhësve, fushatën zgjedhore, rregullat për organizimin dhe funksionimin e administratës zgjedhore, kriteret për hartimin e listës së zgjedhësve, procedurat për votimin, vlerësimin dhe numërimin e votave, shpalljen e rezultateve, procedurat për shqyrtimin e ankimeve si dhe rregullat për administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit.

NENI 5 SUBJEKTI I RREGULLORES

1. Kjo rregullore i shtrin efektet e saj për zgjedhjet për anëtar në KSUFSN, në nivel njësie kryesore dhe institucioni.
2. Subjekt i kësaj rregulloreje janë studentët që ndjekin studimet me kohë të plotë në Universitetin "Fan S. Noli".
3. Studentët kanë të drejtën të zgjedhin dhe të zgjidhen përfaqësues të studentëve në KSUFSN, në nivel njësie kryesore dhe institucioni, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në këtë

KREU II



ORGANIZIMI DHE VEPRIMTARIA E KSUFSN

NENI 6

QËLLIMET E KSUFSN

KSUFSN ka këto qëllime:

1. Të trajtojë shqetësimet e studentëve dhe të veprojë për zgjidhjen e tyre kur studentët kanë të drejtë.
2. Të kontribuojë në rritjen e aftësive organizuese dhe administruese të grupeve me aktivë të studentëve.
3. Të krijojë struktura që shërbejnë për informimin e studentëve dhe të kujdeset për mbarëvajtjen e tyre.
4. Të bashkëpunojë me organet drejtuese të Universitetit, Fakultetit dhe departamentit me synim përmirësimin e nivelit mesimor dhe kërkimor-shkencor.
5. Të krijojë e përforcojë lidhjet midis studentëve të universitetit dhe studentëve të universiteteve të tjera.
6. Të organizojë veprimtari me karakter humanitar, social, edukues apo argëtues sipas rastit me qëllim gjallërimin e jetës studentore.
7. Të ndër marrë veprime që do të ndihmojnë në përmirësimin e gjendjes dhe nevojave të studentëve.
8. Të krijojë struktura ndihmëse në zhvillimin e veprimtarive jashtëshkollore për studentët.
9. Të zhvillojë nivelin kulturor dhe arsimor të studentëve.
10. Të kryejë aktivitete që synojnë argëtimin në format e tij më të larmishme.
11. Të mbështetë përfshirjen e studentëve në organet drejtuese dhe strukturat e tjera të UNIKO

NENI 7

PARIME TË PËRGJITHSHME

1. KSUFSN, është një organizim i pavarur i studentëve i cili nuk zhvillon veprimtari politike dhe ekonomike. Ky këshill promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë.
2. KSUFSN ka strukturën e tij drejtuese në çdo fakultet të Universitetit "Fan S. Noli", në mënyre hierarkike në çdo program studimi, të çdo viti akademik.
3. KSUFSN në fillim të çdo viti akademik harton dhe publikon në faqen zyrtare të Universitetit "Fan S. Noli" kalendarin e veprimtarive të këshillit.
4. Çdo program studimi në çdo vit ka një ose më shumë përfaqësues të studenteve, të cilët kanë për detyrë të raportojë problematikat e studenteve, idete apo kërkesat e tyre tek KSUFSN gjatë zhvillimit të mbledhjeve javore ose mujore në bazë të nevojave.
5. KSUFSN nuk mund të organizohet me struktura të tjera politike e jopolitike jashtë institucionit.
6. KSUFSN shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të Universitetit, si për planet dhe për programet e studimit, rregulloret për veprimtari mësimore, të drejtën për të studiuar, cilesinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.

NENI 8

VEPRIMTARIA E KSUFSN

1. Këshilli Studentor e zhvillon veprimtari në mjediset e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë.
2. KSUFSN mund të zhvillojë sipas rastit veprimtari në të gjitha institucionet shtetërore ose jo, me te cilat UNIKO ka lidhur nje marrëveshje bashkëpunimi.



3. Në funksionimin e Këshillit të Studentëve të Universitetit, të Fakultetit dhe të Departamenteve aplikohen parimet e bashkëpunimit, si dhe të respektit të ndërsjellë.
4. Këshilli i Studentëve të UNIKO, drejtohet nga studentë të zgjedhur me votë nga studentët sipas parimit një anëtar një votë.
5. KSUFSN, drejtohet nga organet drejtuese që veprojnë sipas kompetencave të përcaktuara në rregulloren e përgjithshme të saj.

NENI 9 ORGANIZIMI I KSUFSN

1. Këshilli Studentor i Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, është organi më i lartë vendimmarrës i studentëve me përbërje:
 - a. Presidenti i këshillit studentor
 - b. Zv/presidenti i këshillit studentor.
 - c. Sekretari i këshillit të studentor.
 - d. Kryetarët e Këshillit të Studentëve në fakultete.
 - e. Senatorët e programeve të studimit që janë anëtarët e departamenteve, të ndarë sipas programeve të studimit dhe viteve, pjesë e Këshillit të Studentëve në fakultete.
 - f. Grupet Organizative të eventeve të ndryshme si: sportive, kulturore etj.
 - g. Grupet e punës IT,që do të merren me përpunimin teknik,redaktimin etj.

NENI 10 KOMPETENCAT E KSUFSN DHE KSUFSN TË FAKULTETIT

Këshilli i Studentëve ka këto kompetenca:

1. Zgjedh ose shkarkon nënkryetarin me votim të fshehtë.
2. Zgjedh ose shkarkon sekretarin me votim të fshehtë.
3. Zgjedh ose shkarkon senatorin përfaqësues të çdo departamenti pas propozimit të secilit kurs të programeve të studimit.
4. Krijon komisione të përhershme ose të përkohshme për çështje të ndryshme dhe përcakton mënyrën e funksionimit të tyre.
5. Merr në shqyrtim dhe vendos për propozimet që bëhen nga Universitetet e tjera brenda dhe jashtë vendit me qëllim bashkëpunimin në fusha të ndryshme, duke u konsultuar me Rektoratin e Universitetit “Fan S.Noli” Korçë.
6. Harton dhe miraton së bashku me anëtarët programin vjetor të veprimtarive, duke ja paraqitur Universitetit “Fan S. Noli” Korçë dhe duke e publikuar në faqen zyrtare web të UNIKO.
7. Diskuton edhe tematika të jashtëzakonshme të cilat vihen në rendin e ditës së mbledhjes dhe merr vendime rreth tyre.

NENI 11 PËRBËRJAE KSUFSN

Kryesia e KSUFSN përbëhet nga 7 anëtarë:

1. Presidenti i këshillit studentor
2. Zv/presidenti i këshillit studentor
3. Sekretari i këshillit studentor
4. 4 (katër) Kryetarët e Këshillit Studentor në çdo Fakultet

NENI 12



PËRBËRJA E KSF

Kryesia e këshillit të studentëve në fakultete përbëhet :

- FAKULTETI EKONOMIK (4anetare)
 1. Kryetari i Këshillit të Studentëve të Fakultetit
 2. Dy Nënkyetare te Këshillit të Studentëve të Fakultetit
 3. Sekretari i Këshillit të Studentëve të Fakultetit
- FAKULTETI I BUJQESISE (3 anetare)
 1. Kryetari i Këshillit të Studentëve të Fakultetit
 2. Nënkyetar I Këshillit të Studentëve të Fakultetit
 3. Sekretari i Këshillit të Studentëve të Fakultetit
- FAKULTETI I FILOLOGJISE DHE EDUKIMIT(4 anetare)
 1. Kryetari i Këshillit të Studentëve të Fakultetit
 2. Dy Nënkyetare te Këshillit të Studentëve të Fakultetit
 3. Sekretari i Këshillit të Studentëve të Fakultetit
- FAKULTETI I SHKENCAVE TE NATYRES DHE SHKENCAVE HUMANE(5 anetare)
 1. Kryetari i Këshillit të Studentëve të Fakultetit
 2. Tre Nënkyetare te Këshillit të Studentëve të Fakultetit
 3. Sekretari i Këshillit të Studentëve të Fakultetit



NENI 13

KRYETARI I KSUFNS DHE I FAKULTETIT

1. Mund të jetë çdo student i UNIKO.
2. Kryetari i KSUFNS ka mandat 2 (dy) vjeçar, zgjidhet me votë nga studentët e UNIKO dhe ushtron kompetencat e tij sipas rregullores.
3. Kryetari në fakultet ka mandat 2 (dy) vjeçar, zgjidhet me votë nga studentët e fakultetit ku bën pjesë dhe ushtron kompetencat e tij sipas rregullores.
4. Në rast dorëheqje të tij, detyra e Kryetarit i kalon Nënkyetarit aktual deri në mbarimin e mandatit.
5. Nënkyetari mban njeheresh funksionet e nenkyetarit dhe funksionet e kryetarit te dorehequr
6. Kryetari duhet të kete qene se paku 1 vit pjese e Keshillit Studentor.

NENI 14

KOMPETENCAT E PRESIDENTIT TË KSUFNS

1. Drejton veprimtarinë e Këshillit të Studentëve në bazë të Rregullores.
2. Në veprimtarinë e tij shprehet me sygjerime të cilat më pas votohen.
3. Përfaqëson Këshillin e Studentëve në marrëdhënie me të tretë.
4. Kujdeset për interesat e Këshillit të Studentëve, si dhe i mbron ato.
5. Ka në ngarkim zyrën e Këshillit të Studentëve dhe të gjitha materialet që ndodhen në të.
6. Bën deklarime publike për të shprehur qëndrimin zyrtar të Këshillit të Studentëve mbi çështje të ndryshme pasi është konsultuar me anëtarët e tjerë të KSUFNS.
7. Deleton plotësisht ose pjesërisht kompetencat e tij tek nënkyetari, sekretari i këshillit të studentëve
8. Mban vulen e Këshillit të Studentëve.



9. Merr në shqyrtim propozimet që bëhen nga Universitetet brenda dhe jashtë vendit, me qëllim bashkëpunimin e ndihmën e ndërsjellë, dhe i paraqet para anëtarve.
10. Kujdeset për zbatimin e vendimeve të marra nga Këshilli i Studentëve.
11. Në funksion të transparencës, shqyrton në mbledhjet e tij të gjitha çështjet me karakter financiar, të lidhura me veprimtari të Këshillit të Studentëve, të financuara nga Universiteti.
12. Mban përgjegjësi për administrimin e financës së Këshillit të Studentëve.

NENI 15 ZV/PRESIDENTI I KSUFNS DHE I FAKULTETIT

1. Zv/Presidenti i KSUFNS apo nënkryetari i Fakultetit mund të jetë çdo student i UNIKO.
2. Zv/Presidenti ka mandat 2(dy) vjeçar dhe ushtron kompetencat e tij sipas rregullores.
3. Zv/Presidenti propozohet dhe zgjidhet nga Presidenti i keshillit studentor
4. Presidenti i delegon pjesërisht kompetencat e tij Zv/Presidentit.
5. Në rast dorëheqjeje të Presidentit, merr rolin e tij deri në përfundim të mandatit.

NENI 16 SEKRETARI I KËSHILLIT TË STUDENTËVE

1. Sekretari i KSUFNS propozohet dhe zgjidhet nga Presidenti i keshillit studentor
2. Sekretari i Këshillit të Studentëve në fakultete zgjidhet nga kryetari i fakultetit, ai ka mandat 2 vjeçar dhe ushtron kompetencat e tij sipas rregullores.
3. Sekretari i KSUFNS administron dokumentacionet origjinale të KSUFNS / apo në Fakultete.
4. Mban procesverbalin e mbledhjes dhe harton dokumentet që i kërkohen nga kryetari/nënkryetari.
5. Kryetari i delegon pjesërisht kompetencat e tij.
6. Ndjek të gjithë procesin zgjedhor dhe kujdeset për mbarevajtjen e tij.
7. Të gjithë sekretarët e KSUFNS/fakulteteve, perfundojnë mandatin e tyre vetëm pasi janë zhvilluar zgjedhjet dhe është krijuar KSUFNS pasardhës.

NENI 17 SENATORI I KSUFNS

1. Mund të jetë çdo student i UNIKO.
2. Përfaqësojnë programet dhe kurset e studimit sipas parimit “nga një përfaqësues për çdo kurs dhe program studimi”
3. Propozohet nga studentët e kursit përkatës (jo më pak se 30% e kursit).
4. Firmos një kontratë ose formular anëtarësimi për angazhimin e tij vullnetar, e cila përfshin të gjitha detajet për regjistrimin dhe punën e tij.
5. Merr informacione mbi punën që kryhet nga organizata dhe të vendos bashkëpunim me drejtuesit e saj dhe veprimtarinë e tij të ardhshme.
6. Merr trajnimet dhe udhëzimet e nevojshme për punën që do kryejë.
7. Mbikëqyret dhe ndihmohet vazhdimisht në punën e tij.
8. Trajtohet sipas të drejtave të njeriut, pavarësisht nga feja, politika, origjina etj.
9. Përfiton nga çdo lehtësirë që krijon organizata për anëtarët e saj.
10. Mund të certifikohet për punën e tij si vullnetar pranë KSUFNS ose njësisive të tjera në UNIKO.

NENI 18 DETYRIMET E ANËTARIT TË KSUFNS

1. Të kryejë punën e tij si anëtar sipas marrëveshjes së arritur me drejtuesit e KSUFNS.
2. Të respektojë dhe të veprojë sipas Rregullores së KSUFNS.
3. Të zhvillojë me përgjegjësi dhe në kohën e caktuar detyrat e pranuar dhe në rast pamundësie të njoftojë strukturat përkatëse.
4. Te jetë korrekt dhe i përgjegjshëm.
5. Të japë këshillime, opinione dhe propozime për KSUFNS, për t'i ndihmuar në zhvillimin e suksesshëm të veprimtarive.
6. Të bashkëpunojë në grup me vullnetarët e tjerë, si dhe me strukturën drejtuese të KSUFNS.

NENI 19

KSUFNS DHE UNIKO

1. KSUFNS angazhohet në bashkëpunimin e ngushtë me të gjithë trupën akademike dhe ndihmës-akademike të UNIKO.
2. KSUFNS angazhohet në mbështetjen e Qendrës së Karrierës dhe Alumnit për mbarëvajtjen e veprimtarive me karakter edukativ, kulturor, sportive etj.
3. KSUFNS kryen detyrat e ngarkuara nga Qendra e Karrierës dhe Alumnit për përmbushjen me sukses të veprimtarive vullnetare që organizohen në UNIKO.
4. KSUFNS angazhohet në pjesëmarrje vullnetare në çdo veprimtari të UNIKO, në rastet kur ky angazhim kërkohet nga trupa akademike dhe ndihmës akademike.
5. KSUFNS angazhohet në respektimin dhe rritjen e frymës së bashkëpunimit me trupën akademike dhe ndihmës akademike.
6. Në çdo rast dhe për çdo arsye, KSUFNS nuk mund t'i shmanget detyrimeve për pjesëmarrje në veprimtari që organizohen nga UNIKO, sipas pikave të mësipërme.

NENI 20

SHKARKIMI I PRESIDENTIT DHE KRYETAREVE

1. Kur shpërdoron emrin e KSUFNS për qëllime personale.
2. Kur shkel konfidencialitetin e informacioneve dhe e të dhënave për studentët.
3. Për veprimtari të paligjshme (korrupsion, sekser etj.), në kundërshtim me rregulloren e UNIKO dhe KSUFNS.
4. Merr 3 vërejtje për shkelje të etikës gjatë mbledhjeve, veprimtarive të KSUFNS.
5. Merr 3 mungesa gjate mbledhjeve te KSUFNS
6. Ne rast shkarkimi detyrat e tij i delegohet nenpresidentit dhe nenpresident zgjidhet perseri me votim te fshehte sipas parimit nje anetar nje vote nga kryetaret e fakulteteve.

NENI 21

SHKARKIMI I NËNKRYETARIT, SEKRETARIT DHE SENATORIT TË KSUFNS

1. Kur shpërdoron emrin e KSUFNS për qëllime personale.
2. Kur shkel konfidencialitetin e informacioneve dhe e të dhënave për studentët.
3. Për veprimtari të paligjshme (korrupsion, sekser etj.), në kundërshtim me rregulloren e UNIKO dhe KSUFNS.
4. Merr 3 vërejtje për shkelje të etikës gjatë mbledhjeve, veprimtarive të KSUFNS.
5. Merr 3 mungesa gjate mbledhjeve te KSUFNS
6. Shkarkohet me votim të fshehtë, me shumicë votash nga anëtarët e KSUFNS (Kryetaret, nenkryetaret e fakulteteve, sekretaret e fakulteteve, sekretari i KSUFNS dhe nenkryetari)



KREU III MËNYRA E ZGJEDHJES

NENI 22 TË PËRGJITHSHME

Zgjedhjet për Këshillin e Studentëve, procedurat dhe modalitetet e mbajtjes së tyre rregullohen sipas:

- a. Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
- b. Statutit dhe rregulloreve të UNIKO.
- c. Rregullores së KSUFSN.

NENI 23 PERIUDHA ZGJEDHORE DHE THIRRJA E ZGJEDHJEVE

1. Periudha zgjedhore dhe data e zgjedhjeve, shpallet me urdhër të Presidentit të KSUFSN, duke marrë parasysh afatet e nevojshme për krijimin e komisioneve përkatëse dhe zhvillimin e fushatës zgjedhore.
2. Qendrat e votimit hapen në orën 9:00 dhe mbyllen në orën 15:00. Askush nuk mund të votojë pasi komisionet e qendrave të votimit të fakulteteve të Universiteti "Fan S. Noli" kanë marrë vendim për mbylljen e votimit, pasi janë siguruar për votimin e të gjithë studentëve që janë në radhë, në pritje të votimit, në orarin e mbylljes së votimit.
3. Zgjedhjet për President të KSUFSN-së, Kryetar i KSF-së, zhvillohen brenda së njëjtës ditë.
4. Zgjedhjet për President të KSUFSN-së, Kryetar i KSF-së, mbahen në mënyrë periodike çdo 2 (dy) vjet.
5. Çdo kandidat ka të drejtë të organizojë dhe të zhvillojë aktivitete për paraqitjen e programit të tij, duke mos cenuar procesin mësimor.

NENI 24 KOMISIONET ZGJEDHORE

1. Këshilli i Studentëve zgjedh anëtarët që do të merren me komisionet e zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme.
2. Anëtarët e komisioneve vetëkandidohen në KSUFSN dhe kanë mandat 2 – vjeçar.

NENI 25 ORGANIZIMI DHE MËNYRA E FUNKSIONIMIT TË ZGJEDHJEVE

1. Zgjedhjet mbahen, organizohen dhe drejtohen nga KIZS i Universitetit "Fan S. Noli"
2. Mënyra e votimit është e fshehtë dhe nuk çënohet e drejta e zgjedhësit për të votuar.
3. Zgjedhësi hyn i vetëm në dhomën e fshehtë dhe shpreh vullnetin e tij në mënyrë konfidenciale në fletët e votimit.
4. Zgjedhjet e përgjithshme për riformimin e KSUFSN bëhen një herë në dy vjet, në fillim të vitit akademik.
5. Zgjedhjet e përgjithshme duhet të fillojnë jo më vonë se java e tretë e fillimit të vitit akademik.
6. Zgjedhjet e përgjithshme duhet të përfundojnë jo më vonë se java e katërt e fillimit të vitit akademik.
7. Votimi në zonat elektorale bëhet i fshehtë.
8. Zgjedhja e studentëve bazohet në të drejtën e çdo studenti për të zgjedhur dhe për t'u



- zgjedhur.
9. Data e fillimit të fushatës elektorale shpallet nga Rektori jo më vonë se java e dytë e muajit përkatës.
 10. Fushata elektorale vazhdon deri në përfundim të zgjedhjeve.
 11. Rektori, administratori apo dekanët marrin masat për të vënë në dispozicion strukturat dhe personat, në mbështetje të organizimit teknik të zgjedhjeve për këshillin studentor.
 12. Njoftimi për datën e zgjedhjeve bëhet publik në mjediset e fakulteteve dhe UNIKO.
 13. Administratori i UNIKO merr masat për të siguruar bazën materiale për zhvillimin e procesit të votimit.
 14. Zgjedhjet zhvillohen në bazë të parimeve demokratike, të garantimit të së drejtës së votës së lirë dhe të fshehtë, të një procesi transparent, duke u bazuar në përdorimin e një liste votuesish, kuti votimi transparente, përdorimit të fletëve të votimit të vulosura, të numërimit të fletëve të votimit dhe të shpalljes së rezultateve në prezencë të votuesve.
 15. Votimi kryhet i fshehtë, me fletë votimi standarte, në kushtet e një procesi të përpiktë.
 16. Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin idetë, opinione dhe qëndrimet e tyre përballë komunitetit studentor nëpërmjet përdorimit të mjediseve të fakulteteve jashtë kohës së përdorimit akademik dhe mediat e shkruara dhe elektronike.

NENI 26

KOMISIONET E ZGJEDHJEVE

1. KIZS krijohet me zgjedhje nga KSUFNSN të paktën një muaj para shpalljes së datës së fillimit të fushatës elektorale.
2. Mandatimi i KIZS bëhet nga KSUFNSN dhe zgjat deri 1 muaj pas përfundimit të gjithë procesit të zgjedhjeve të përgjithshme dhe të brendshme të KSUFNSN.
3. KZFS krijohet nga KIZS pas vetëkandidimit të studentëve në KIZS për çdo fakultet jo më vonë se 7 ditë nga krijimi i KIZS.
4. Anëtarët e KIZS janë kryetari i komisionit, sekretari dhe studentë të tjerë duke përfaqësuar çdo fakultet.
5. Anëtarët e KZFS janë kryetari i komisionit, sekretari dhe studentë të tjerë ku të përfaqësohet çdo departament.
6. Anëtarët e KIZS/KZFS propozohen ose vetëkandidohen.
7. Pesë anëtarët e KIZS votohen me votim të fshehtë nga KSUFNSN.
8. Kryetari i KIZS drejton mbledhjen e KSUFNSN në të cilën zgjidhet kryetari i ri.
9. Anëtarët e KIZS/KZFS duhet të jenë studentë të Universitetit të cilët nuk janë senatorë dhe nuk kandidojnë për asnjë nga pozicionet e KSUFNSN.
10. Mbledhjet e KIZS/KZFS janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se ½ e anëtarëve.
11. Vendimet e KIZS/KZFS merren me shumicë votash.

NENI 27

KOMPETENCAT E KIZS

1. Organizon zgjedhjet e përgjithshme/pjesëshme të KSUFNSN.
2. Numëron votat dhe shpall fituesit për kryetar të KSUFNSN dhe kryetar të fakultetit.
3. Shqyrton ankesat e palëve të ndryshme dhe kur e shikon të arsyeshme, jo më vonë se 48 orë, merr vendim përpërsëritjen e procesit zgjedhor në mënyrë të pjesëshme ose tërësore.
4. Mandaton kandidatët për senator që kanë fituar zgjedhjet, jo më vonë se një javë nga dita e përfundimit të zgjedhjeve.

NENI 28

KOMPETENCAT E KZFS



1. Organizon zgjedhjet e përgjithshme/pjeshme të KSUFNS.
2. Mbledh propozimet/vetëkandidimet e senatorëve të programeve të studimit dhe ja përcjell KIZS.
3. Shqyrton ankesat e palëve të ndryshme dhe kur e shikon të arsyeshme, jo më vonë se 48 orë, merr vendim përpjesëritjen e procesit zgjedhor në mënyrë të pjeshme ose tërësore.
4. Merr rolin e qendrës së votimit për zgjedhjen e kryetarit të KSUFNS dhe kryetarëve të fakulteteve.
5. Miraton listën e senatorëve të regjistruar për çdo program studimi jo më vonë se një javë nga dita e përfundimit të zgjedhjeve.

NENI 29

ZGJEDHËSIT DHE PËRGATITJA E LISTËS SË ZGJEDHËSVE

1. Kanë të drejtën e zgjedhjes të gjithë studentët e UNIKO.
2. Kanë të drejtën për të kandiduar të gjithë studentët e UNIKO.
3. Struktura përgjegjëse për hartimin e listës së zgjedhësve është sekretaria mësimore e fakultetit përkatës, duke ndarë më vete listat sipas secilit program studimi.
4. Procedurat për hartimin e listës së zgjedhësve është si më poshtë:
 - a) Lista paraprake e studentëve hartohet nga sekretaria mësimore jo më vonë se 3 (tri) ditë nga shpallja e ditës së zgjedhjeve;
 - b) Lista paraprake afishohet në mjediset e fakulteteve përkatëse;
 - c) Gjatë një periudhe deri në 3 (tre) ditë pas shpalljes së listës paraprake, sekretaria mësimore pranon kërkesa për korrigjime;
 - d) Pas verifikimit të kërkesës, sekretaria mësimore realizon korrigjimin e kërkuar brenda 24 (njëzet e katër) orësh;
 - e) Pas përfundimit të afatit për korrigjimin e listës, sekretaria mësimore harton listën përfundimtare, e cila miratohet nga dekani i fakultetit përkatës.
5. Lista e zgjedhësve afishohet në mjediset e fakultetit përkatës dhe një kopje e listës i dërgohet KIZS-së. Lista e miratuar duhet të jetë e firmosur në çdo faqe nga dekani dhe e vulosur me vulën e fakultetit përkatës.

NENI 30

DOKUMENTACIONI PËR KANDIDIM

1. Dokumentacioni për kandidim nga kandidatët për Kryetar të KSUFNS-së ; Kryetar të KSUFNS-së dorëzohet në KIZS dhe përmban:
 - a) Kërkesën për kandidim e cila përfshin: emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe një deklaratë të shprehjes së vullnetit për kandidim për kryetar dhe senator të këshillave në nivel njësie kryesore dhe institucioni;
 - b) Fotokopje e dokumentit të identifikimit;
 - c) Vërtetim që provon se është student me kohë të plotë pranë fakultetit përkatës dhe notën mesatare për rastet kur është kriter;
 - d) kandidati për President të KSUFNS duhet të depozitojë një listë të nënshkruar nga 40 (dyzetë) studentë; 10 (dhjete) nga cdo Fakultet
 - e) Kandidati për Kryetar Fakulteti të KSUFNS duhet të depozitojë një listë të nënshkruar nga 30 (tridhjetë) studente nga fakulteti përkatës.
2. Pas verifikimit të dokumentacionit, KIZS-ja, jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim, miraton listat e kandidatëve për kryetar dhe anëtar të këshillave në nivel njësie kryesore dhe institucioni, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
3. Listat e kandidatëve për kryetar të këshillave në nivel njësie kryesore dhe institucioni



- shpallen publikisht në mjediset e UNIKO.
- Kandidatët për senator përveç dokumenteve të pikës 1 (a, b dhe c) dorëzojnë edhe listën e studentëve të kursit që e propozojnë.



NENI 31
KANDIDIMI PËR PRESIDENT TË KSUFNS

- Të drejtën e kandidimit për President të Këshillit të Studentëve dhe Kryetar të fakulteteve kanë:
 - Studentët e UNIKO.
 - Studentët të cilët janë angazhuar sëpaku 1 vit në KSUFNS
 - Studentët ndaj të cilëve nuk është marrë masë disiplinore.
 - Te mos jete student i vitit te parë

NENI 32
EMERIMI I KRYESISE TE KESHILLIT STUDENTOR

- Të drejtën e emerimit të zv/Presidentit dhe sekretarit të përgjithshëm e ka Presidenti i zgjedhur
- Zv/Presidenti, Sekretari i përgjithshëm dhe Presidenti duhet të jenë nga fakultete të ndryshme

NENI 33
EMERIMI I KRYESISE TE FAKULTETEVE

- Të drejtën e emerimit të nenkryetarit/ve dhe sekretareve të KSUFNS e ka kryetari i zgjedhur
- Kryetari, Nenkryetari dhe sekretari duhet të jenë nga programe të ndryshme

NENI 34
KANDIDIMI PËR SENATOR DHE MËNYRA E ZGJEDHJES

- Të drejtën e kandidimit për senator të KSUFNS e ka çdo student i UNIKO.
- Çdo student ka të drejtën të vetëkandidohet ose propozohet nga secili kurs i programeve të studimit.

NENI 35
FUSHATA ZGJEDHORE

- Fushata zgjedhore fillon një ditë pas shpalljes së kandidatëve të regjistruar.
- Fushata zgjedhore përfundon 24 (njëzet e katër) orë para ditës së zgjedhjeve. Dita para datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve deri në mbylljen e votimit formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë fushatë zgjedhore.
- Administratori dhe administrata e UNIKO-së, krijojnë kushtet e përshtatshme dhe të barabarta për të gjithë kandidatët për të zhvilluar veprimtarinë e tyre në kuadër të fushatës zgjedhore. Në përputhje me kërkesën e kandidatit për kohën dhe vendin për zhvillimin e aktivitetit, administrata e UNIKO-së, merr të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e tij, pa cenuar procesin mësimor, si dhe përcakton mjediset dhe plotëson kërkesat e komisioneve të ngritura në fakultetin përkatës, me qëllim zhvillimin e zgjedhjeve.
- Fushata zgjedhore zgjat 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes së kandidaturave për kryetar të KSUFNS dhe kryetarëve për fakultet.



KREU V
PËRGATITJA E INFRASTRUKTURËS DHE DOKUMENTACIONIT

NENI 36
VENDNDODHJA E KOMISIONEVE ZGJEDHORE DHE VENDEVE TË
NUMËRIMIT TË VOTAVE

1. Vendndodhja e komisioneve zgjedhore përcaktohet sipas rregullit të mëposhtëm:
 - a. Zyrat e KIZS-së vendosen në godinën e Rektoratit të UNIKO;
 - b. Zyrat e KZSF-ve vendosen në godinat e fakulteteve përkatëse të UNIKO, të cilat shërbejnë edhe si qendra e votimit dhe numërimit të votave.

NENI 37
KOMISIONET PËR VLERËSIMIN DHE NUMËRIMIN E VOTAVE

1. Votat vlerësohen dhe numërohen prej KZSF-ve përkatëse.
2. KZSF- të përkatëse të UNIKO, pas numërimit të votave, plotësojnë tabelën zgjedhore dhe ia përcjellin atë KIZS-së.
3. KIZS- ja shpall rezultatin e zgjedhjeve sipas përcaktimeve në këtë rregullore dhe pas kalimit të afateve për ankimimin, shpall fituesin e zgjedhjeve.

NENI 38
PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT ZGJEDHOR

1. Sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve sipas listave, plus 1% e tyre.
2. Për zgjedhjen e Kryetarit të KSUFNS, Kryetarit të KSF-së studentët do të votojnë me 2 (dy) fletë me ngjyra të ndryshme.
3. Forma e fletës së votimit përgatitet nga KIZS-ja.
4. Fletët e votimit përmbajnë informacionet e mëposhtme:
 - a. Në to vendosen emrat e kandidatëve për kryetar në nivel njësie kryesore dhe institucioni;
 - b. Të gjitha fletët e votimit vulosen me vulën e KIZS-së përpara se të dërgohen në KZSF-të e fakulteteve.

NENI 39
DËRGIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE NGA KIZS-JA NË KZSF

1. KIZS-ja dërgon në KZSF kutinë e materialeve zgjedhore, si më poshtë vijon:
 - a. Fletët e votimit të vulosura me vulën e KIZS-së në përputhje me numrin e votuesve (+1%);
 - b. Listën e zgjedhësve;
 - c. Vulat e KZSF-ve përkatëse;
 - d. Procesverbalet e qendrës së votimit, ku do të bëjnë pjesë procesverbalet për vulosjen e kutive të votimit, hapjen e qendrës së votimit, pezullimin e votimit, si dhe mbylljen e votimit;
 - e. Zarfën në të cilin është shënuar "Fletëvotimi të dëmtuara";
 - f. Zarfën në të cilin është shënuar "Fletëvotimi të papërdorura";
 - g. Zarfën në të cilin është shënuar "Zarf i procesverbalit të vulosjes".
2. Përveç kutisë me materiale zgjedhore, në KZSF dërgohen edhe kutitë e votimit, tabelat për rezultatin e zgjedhjeve dhe dhomat e fshehta.
3. KIZS-ja shpërndan bazën materiale të nevojshme për zhvillimin e votimit në KZSF-në ngritur në fakultetin përkatës. Ky proces bëhet ditën e zgjedhjeve, përpara fillimit të procesit të votimit, dhe pasqyrohet në procesverbalin përkatës.



KREU VI VOTIMI

NENI 40

VEPRIMET PARAPRAKE PËR HAPJEN E QENDRËS SË VOTIMIT

1. Në çdo qendër votimi votohet në dy kuti votimi, kutia e votimit për Kryetar të KSUFNS dhe për Kryetar të KSF.
2. KZSF-të, nën drejtimin e kryetarit, një orë përpara hapjes së qendrës së votimit kryejnë këto detyra:
 - a) Vendosin tryeza, karrige, dhoma të fshehta dhe kutitë e votimit, në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit, si dhe lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve;
 - b) Afishojnë udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm brenda qendrës së votimit;
 - c) Kontrollonjë të gjitha materialet e marra në dorëzim;
 - d) U tregojnë të pranishmëve kutitë e votimit të zbrazëta;
 - e) Mbyllin kutitë e votimit dhe i shkruajnë këto kode në procesverbalin e vulosjes së kutive të votimit dhe në librin e protokollit të mbledhjeve, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KZSF-së.
3. Procesverbali mbyllet në zarfën ku është shkruar "Zarfi i procesverbalit të vulosjes", i cili futet në kutinë e votimit. Anëtarët e KZSF-ve marrin vendimin për hapjen e votimit dhe e nënshkruajnë atë.

NENI 41

PROCEDURA E VOTIMIT

1. Votimi për Kryetar të KSUFNS dhe kryetar të KSF-së bëhet në të njëjtën ditë në të gjitha fakultetet e UNIKO, në datën e përcaktuar nga Rektori. Pas kryerjes së detyrave të përcaktuara në këtë rregullore, kryetari i KZSF-së deklaron hapjen e votimit, por jo më vonë se ora 09:00.
2. Fletët e votimit janë të vulosura në pjesën e pasme, në vendin e caktuar, me vulën e KZSF-së. Zgjedhësit qëndrojnë në radhë jashtë qendrës së votimit dhe futen njëri pas tjetrit në qendrën e votimit për të votuar, me thirrjen e një anëtari të komisionit. Pasi zgjedhësi hyn në qendrën e votimit:
 - a) thotë emrin e tij dhe paraqet para komisionit një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identifikimit (letërnjoftim ID ose pasaportë).
 - b) kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe pasi zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë së dokumentit të identitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë;
 - c) nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij;
 - d) kryetari vulos fletën e votimit me vulën e KZSF-së dhe ia jep zgjedhësit;
 - e) pasi merr fletën e votimit, hyn në dhomën e fshehtë dhe në krah të emrit të kandidatit shënon me një nga shenjat identifikuese (x,v,+) votën pro kandidatit.
 - f) në rastet kur ka vetëm një kandidat fleta e votimit ka opsionet PRO/KUNDËR
 - g) pasi bën shënimin në fletën e votimit, palos fletën në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, del nga dhoma e fshehtë, e hedh fletën në kutinë përkatëse të votimit dhe largohet nga qendra e votimit.
3. Qendra e votimit organizohet në një mënyrë të tillë që të lehtësojë procesin e votimit dhe të garantojë plotësisht fshehtësinë e votës.
4. Në qendrën e votimit është i ndaluar përdorimi i mjeteve të komunikimit apo regjistrimi nga ana e votuesit.



5. Në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm:
 - a) anëtarët e KZSF-së dhe vëzhguesit e miratuar nga KIZS-ja për llogari të kandidatëve;
 - b) zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit, deri në përfundim të tyre.

NENI 42

MBYLLJA E VOTIMIT

1. Qendrat e votimit mbyllen në orën 15:00. Nëse edhe pas kalimit të këtij orari ka zgjedhës që presin në radhë, komisioni mbledh dokumentet e identifikimit e të gjithë zgjedhësve të pranishëm dhe i thërret ata me radhë për të kryer votimin.
2. Asnjë zgjedhës tjetër nuk do të lejohet të votojë nëse nuk ka qenë në radhë në kohën e mbledhjes së dokumenteve të identifikimit. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit i pranishëm, komisioni merr vendim për mbylljen e votimit, duke plotësuar formularin përkatës, ku shënohet edhe ora e mbylljes së votimit. Pas kësaj, në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët e komisionit.

NENI 43


VEPRIMET PAS MBYLLJES SË QENDRËS SË VOTIMIT

1. Pas marrjes së vendimit për mbylljen e votimit, kryetari, në praninë e anëtarëve të komisionit kryen, sipas radhës, veprimet e mëposhtme:
 - a. shënon numrin e zgjedhësve që kanë votuar, duke numëruar nënshkrimet e bëra në listën përkatëse të zgjedhësve, të cilët kanë votuar sipas kushteve të parashikuara në këtë rregullore;
 - b. iu deklaron shifrat me zë të lartë anëtarëve të tjerë të komisionit;
 - c. i fton ata të verifikojnë shifrat e thëna prej tij.
2. Në rast kundërshtimesh për përcaktimin e shifrës, pretendimet shënohen në procesverbal.
3. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, i numëron fletët e votimit të dëmtuara që gjenden në zarfin "Fletëvotimi të dëmtuara" për secilën kategori. Numri i fletëve të votimit të dëmtuara pasqyrohet në procesverbalin për "Mbylljen e votimit".
4. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit numëron dhe fletët e papërdorura dhe i vendos ato në zarfin përkatës. Numri i fletëve të votimit të papërdorura pasqyrohet në procesverbalin për "Mbylljen e votimit".
5. Procesi vijues i vlerësimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit për zgjedhjet e KS-së së UNIKO, Kryetar të KS-së dhe anëtar të KS-së kryhet nga KZSF-të përkatëse dhe vazhdon pa ndërprerje deri në nxjerrjen e rezultatit përfundimtar për fakultetin.
6. Kryetari i KZSF-së, bashkë me anëtarët e tjerë të komisionit, dorëzojnë në KIZS kutitë e votimit bashkë me materialet zgjedhore të qendrës së votimit.

NENI 44

VLERËSIMI, NUMËRIMI I VOTAVE DHE NXJERRJA E REZULTATIT PËR ZGJEDHJET E KSUFSN

1. Procesi i vlerësimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit për zgjedhjet e Këshillit Studentor kryhet nga KZSF-të përkatëse dhe vazhdon pa ndërprerje deri në nxjerrjen e rezultatit përfundimtar për fakultetin përkatës.
2. Kryetari i KZSF-së nxjerr nga kutia e votimit fletët e votimit, i shpalos dhe i vendos mbi tryezë, me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme. Pas kësaj ai:
 - a. vlerëson të gjitha votat e gjetura në kuti, duke ia treguar të gjithë anëtarëve të



- KZSF-së. Votat e pavlefshme ndahen në një grup të veçantë;
- b. numërohen votat e vlefshme dhe votat e pavlefshme. Numri i tyre, së bashku me numrin e përgjithshëm të votave të gjetura në kuti shënohen në procesverbal;
 - c. verifikon numrin e përgjithshëm të votave të gjetura në kuti me numrin e votave që duhet të gjenden në kuti, në bazë të të dhënave të procesverbalit të hartuar më parë nga KZSF-ja, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, për numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit, fletëve të votimit të papërdorura dhe fletëve të votimit të dëmtuara. Rezultati shënohet në procesverbal;
 - d. harton tabelën përfundimtare për kutinë përkatëse dhe e miraton me vendim.
3. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:
- a. fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KZSF-ja;
 - b. fletës së votimit i mungon vula;
 - c. në fletët e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës;
 - d. në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose disfavor të studentit kandidat;
 - e. është votuar në tejkalim të përcaktimeve në fletën e votimit;
 - f. nuk është votuar për asnjë kandidat.
4. Në rastet kur ka një kandidat, për t'u shpallur fitues kandidati duhet të marrë 50%+1 vota PRO nga fletët e votimit të vlefshme në kutinë e votimit.
5. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave, KZSF-ja harton tabelën përfundimtare të rezultatit të votimit sipas numrit të votave.
6. Tabela përfundimtare dhe vendimi përkatës i KZSF-së, si edhe të gjitha procesverbalet e tjera nënshkruhen nga të gjithë anëtarët dhe kryetari, duke deklaruar votën "pro"ose "kundër".
7. Kopje e tabelës përfundimtare të rezultatit të votimit u jepet, sipas kërkesës, kandidatëve.
8. Çdo kontestim apo vërejtje e kandidatëve shënohen detyrimisht në procesverbal nga sekretari i KZSF-së.
9. Në përfundim të procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave, në prani të KZSF-së dhe/ose kandidatëve të pranishëm:
- a. futen dhe administrohen në kutitë e votimit të numëruara të vlefshme dhe të pavlefshme;
 - b. futen dhe administrohen në kutinë e materialeve zgjedhore zarfi "Fletëvotimi të papërdorura";
 - c. futen dhe administrohen në kutinë e materialeve zgjedhore zarfi "Fletëvotimi të dëmtuara";
 - d. futen dhe administrohen në kutinë e materialeve zgjedhore procesverbali për numrin e fletëve të votimit gjithsej, numrin e fletëve të papërdorura dhe numrin e fletëve të dëmtuara, si edhe tabela përfundimtare e rezultatit të votimit për KZSF-në përkatëse.
10. Kryetari i KZSF-së mbyll kutitë e votimit dhe shënon në procesverbalin elementet e sigurisë (kodet) për mbylljen e këtyre kutive.
11. Dorëzimi i materialeve zgjedhore dhe i kutive të votimit në KZSF bëhet nga kryetari i KZSF-së me procesverbal, në prani të anëtarëve të KZSF-së përkatëse dhe /ose kandidatëve, menjëherë pas përfundimit të proceseve të përshkruara në këtë rregullore.



NENI 45

SHPALLJA E REZULTATIT PARAPRAK TË ZGJEDHJEVE PËR KSUFNS

1. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave, nxjerrjes së rezultatit të votimit nga të gjitha KZSF-të dhe dërgimit të tyre në KIZS, ky i fundit, brenda 24 (njëzet e katër) orëve, harton tabelën e rezultateve të votimit dhe shpall, me vendim të veçantë, rezultatit e zgjedhjeve për anëtarët dhe kryetarët e këshillave studentor në nivel të njësisive kryesore dhe të institucionit.
2. Tabela e rezultateve zgjedhore dhe vendimi i KIZS-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët.
3. Kopje e tabelës përfundimtare të rezultatit të zgjedhjeve u jepet, sipas kërkesës, kandidatëve.

NENI 46

ANKIMIMET

1. Kundër vendimeve të KZSF-së për shpalljen e tabelave përfundimtare të rezultatit të zgjedhjeve, ankimimi bëhet nga kandidatët në KIZS, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga data e shpalljes së tyre. Për efekt të llogaritjes së afatit, periudha 2-ditore fillon në orën 16:00 të ditës së shpalljes së aktit për të cilin bëhet ankimimi dhe përfundon në orën 16:00, pas 2 (dy) ditëve kalendarike. KIZS-ja administron dhe merr vendime për ankimimet jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë pas paraqitjes së tyre.
2. Kundër vendimeve të KIZS-së për ankesat e kandidatëve për rezultatit e zgjedhjeve, apelimi i vendimit bëhet nga kandidatët në KAS, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga data e marrjes së vendimit. Për efekt të llogaritjes së afatit, periudha 2-ditore fillon në orën 16:00 të ditës së shpalljes së aktit për të cilin bëhet ankimimi dhe përfundon në orën 16:00, pas 2 (dy) ditëve kalendarike.
3. Me përfundimin e procesit të shqyrtimit të ankimimeve të dërguara nga KAS-i, KIZS-ja shpall, me vendim të veçantë, rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve.

NENI 47

KOMISIONI I APELIT STUDENTOR

1. KAS është organi i apelimit i cili pranon ankesat e kandidatëve për rezultatit e zgjedhjeve jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike ngashpallja e rezultatit të zgjedhjeve.
2. Pas shqyrtimit të ankesës, KAS duhet të marrë vendim brenda 24 (njëzet e katër) orëve lidhur me ankesën e kandidatit.
3. Vendimet e KAS janë vendime të pakonstetueshme.
4. Mandati i KAS është 2 (dy) vjeçar.
5. KAS përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të studentëve.
6. Anëtarët e KAS zgjidhen nga KSUFNS me pëlqimin e anëtarëve të KSUFNS.
7. Të drejtën për kandidim në KAS e ka çdo student i UK që nuk është në vitin e parë të studimeve dhe nuk kandidon për asnjë pozicion tjetër të KSUFNS apo KIZS.

NENI 48

KONSTITUIMIT I KSUFNS DHE KSF-VE

1. Pas përfundimit të afateve të apelimit KIZS-ja me vendimin shpall fituesin për pozicionin e Kryetarit të KSUFNS dhe kryetarët e KSF-ve.
2. KIZS-ja brenda 5 (pesë) ditëve, emëron Kryetarët e KSF-ve të shpallur fitues.
3. Kryetarët e zgjedhur të KSF-ve brenda 3 (tre) ditëve nga emërimi zgjedhin senatorët e



- programeve të studimit sipas kandidaturave të shpallura nga KIZS.
4. Kryetarët e zgjedhur të KSF-ve brenda 6 (gjashtë) ditëve nga emërimi thërrasin KSF-në. Pas konstituimit të KSF-ve me votë të fshehtë zgjidhen 4 (katër) anëtarët që do të përfaqësojnë Fakultetin në KSUFNS.
 5. KIZS-ja brenda 10 (dhjetë) ditëve nga konstituimit i KSF-ve thërret KSUFNS dhe organizohet mbledhja e parë e KS. Në këtë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët dhe Kryetari i KSUFNS, të shpallur fitues nga zgjedhjet e zhvilluara.

NENI 49

PAVLERFSHMËRIA E ZGJEDHJEVE

1. KIZS-ja, kryesisht ose me kërkesë të kandidatëve, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një ose më shumë qendra votimi, në rast se:
 - a) kanë ndodhur shkelje të ligjit;
 - b) mund të jetë cenuar procesi zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në fitimin e mandateve;
 - c) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim.
2. Kërkesën për pavlefshmëri të zgjedhjeve, kërkuesi, duhet ta shoqërojë me shpjegimin për arsyet ligjore ku mbështetet kërkesa, përshkrimin e shkeljeve të pretenduara dhe arsyetimin e detajuar të tyre për pasojat që kanë prodhuar. Shqyrtimi i kërkesës për pavlefshmëri të zgjedhjeve dhe vendimmarrja për kërkesën bëhet nga KIZS-ja, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga depozitimi i saj.

NENI 50

DETYRIMET TË UNIVERSITETIT PËR KSUFNS

1. Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, ka detyrim ligjor të mbështesë KSUFNS dhe të financojë veprimtaritë e tij.
2. Në rastet kur nga ana e organeve drejtuese të Universitetit apo anëtarëve të stafit akademik shprehet kundërshtim i pabazuar ndaj veprimtarive, anëtarëve të KSUFNS u lind e drejta të drejtojnë një kërkesë në formë ankese në Këshilli i Etikës.
3. UNIKO ka për detyrë të verë në dijëni KSUFNS nëpërmjet shkresave zyrtare për çdo ndryshim apo vendim që ndërrmer në lidhje me procesin mësimor, kuadrin administrativ dhe atë ligjor, veprimtaritë dhe axhendën që ka planifikuar Universiteti duke përfshirë takimet me personalitete, konferenca, bilancin, të ardhurat dhe shpenzimet për gjatë gjithë vitit akademik etj.

NENI 51

FINANCIMI I VEPRIMTARISË SË KSUFNS

Bazuar në nenin 99, pikën 6, të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Universiteti "Fan S. Noli" Korçë financohet veprimtari të Këshillit të Studentëve.

NENI 52

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Sekretari i Këshillit të Studentëve konsultohet për hartimin dhe ndryshimet e Rregullores.
2. Kjo rregullore mund të ndryshohet me propozimin e shumicës së anëtarëve të Këshillit të Studentëve.
3. Ndryshimet mund të bëhen vetëm me votimin e shumicës së anëtarëve të Këshillit të



- Studentëve.
4. Pas miratimit të ndryshimeve në statut ai dërgohet për miratim tek Senati Akademik i Universitetit "Fan S. Noli" .
 5. I gjithë dokumentacioni zgjedhor ruhet në arkivin e KSUFSN, në bazë të rregullave të përcaktuara në kuadrin ligjor për administrimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.
 6. Të drejtën e interpretimit të kësaj rregulloreje e ka KIZS-ja, e cili mund të ofrojë mbështetje përgjatë gjithë procesit zgjedhor.
 7. Kjo rregullore është e detyrueshme për t'u zbatuar si e tillë nga të gjitha strukturat studentore të KSUFSN dhe hyn në fuqi menjëherë.
 8. KSUFSN ka logon dhe vulën e vet.



MIRATUAR
Këshilli Studentor i Universitetit "Fan S. Noli"

Presidenti

Nënpresidenti

Sekretari



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
KËSHILLI STUDENTOR

Nr. 285 Prot
21.02.2022

Korçë, më 17.02.2022

LISTA EMËRORE E KËSHILLIT STUDENTOR

- Kodhel Zere, President I Këshillit Studentor.
 - Aldi Rustemi, Zv. President I këshillit studentor.
 - Fjorela Dine, Sekretare e përgjithshme e këshillit studentor.
- FAKULTETI I EKONOMISË
- Xhoni Pajo, Kryetar i fakultetit të Ekonomisë.
 - Amarilda Mejdolli, Zv. Kryetare e fakultetit të Ekonomisë.
 - Klarisa Vagollari, Zv. Kryetare e fakultetit të Ekonomisë.
 - Rinesa Bufi, Sekretare e Fakultetit të Ekonomisë.

FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË

- Amanda Qose, Kryetare e fakultetit të edukimit dhe filologjisë.
- Elçino Agolli, Zv. Kryetar I fakultetit të edukimit dhe filologjisë.
- Rozalinda Bebri, Zv. Kryetare e fakultetit të edukimit dhe filologjisë.
- Rosela Plasari, sekretare e fakultetit të edukimit dhe filologjisë.

FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE DHE HUMANE

- Xhusiela Tanasica, Kryetare e fakultetit të shkencave natyrore dhe humane.
- Rigels Hoxha, zv. kryetar I fakultetit të shkencave natyrore dhe humane.
- Egi Zoto, zv kryetare e Fakultetit të shkencave natyrore dhe humane.
- Klea Zyferi, Zv. Kryetare e Fakultetit të infermierisë.
- Maria Xheli, sekretare e fakultetit të shkencave natyrore dhe humane.

FAKULTETI I BUJQËSISË

- Xhuljana Metko, kryetare e Fakultetit të bujqësisë
- Endi Serjanaj, Zv kryetar I fakultetit të Bujqësisë
- Mateos Qerimi, zv. Kryetar I fakultetit të bujqësisë.

President i Këshillit Studentor

Kodhel Zere

